

## TRASHËGIMIA E NJË HISTORIANI

*Kushtuar Prof.Dr. Hysni Myzyri*

Në redaksinë e revistës “Univers”, që nga 1 shkurti, një vend ka mbetur bosh. Anëtari i redaksisë, prof.dr. Hysni Myzyri (Elbasan, shkurt 1935 – Tiranë, shkurt 2007), ndërroi jetë pas një sëmundjeje të rëndë, që e këputi në pjekurinë më të madhe të veprimtarisë së tij shkencore. Ai është autor i një numri të madh veprash me karakter historiko-shkencor: “Shkollat e para kombëtare shqipe” (1973), “Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip” (1979), “Nuçi Naçi” (Jeta dhe Vepra), (Tiranë, 1986), “Arsimi Kombëtar Shqiptar (1908-1912)” (Prishtinë, 1996) botim i entit të teksteve dhe mjeteve arsimore të Kosovës, “Pandeli J. Evangjeli” (2004), “Shkolla normale e Elbasanit (1909-1912)” (Tiranë, 2004). Si bashkautor, ai ka botuar: “Historia e Shqipërisë”, Vëll. II, Tiranë, 1984; ka mbuluar mjaft zëra në “Fjalorin enciklopedik shqiptar”, Tiranë, 1985; “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjikë shqiptar”, Vëll. I (Kreu i pestë Zhvillimi i arsimit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX (1882-1908) dhe kreu VI - Shkolla kombëtare Shqipe (në vitet 1908- 1912), Tiranë, 2003. Prof.dr. Hysni Myzyri është bashkautor dhe redaktor përgjegjës i botimit “Historia e popullit Shqiptar për shkollat e mesme”, Tiranë, 1994. Ai është, gjithashtu, bashkautor i teksteve mësimore të historisë për shkollat tetëvjeçare e të mesme, të botuara në Tiranë dhe në Prishtinë. Prof.dr. Hysni Myzyri ka zhvilluar një veprimtari të gjerë si publicist i problemeve historike (sidomos në fushën e arsimit) në revistat: “Studime historike”, “Studime filologjike”, “Univers”, “Revista pedagogjike”, “Historia e arsimit” si dhe në shtypin e përditshëm. Për më se tri dekada ai ligjëroi plot sukses në Universitetin e Tiranës. U shqua si pedagog i suksesshëm, duke shërbyer, shpjeguar dhe arsyetuar si shembullor në paraqitjen

e situatave politike-historike, analizës shkencore dhe thellësisë shkencore që e dallonte prof. Hysniun.

Ai punoi pranë Drejtorisë së Arkivave të Shtetit me një seriozitet të madh shkencor, me korrektësi të veçantë, duke lënë emër të mirë për punët që bënte dhe shembullin që linte.

Për meritat që kishte, iu besua detyra e shefit të Departamentit të Historisë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të UT dhe detyra e zëvendës drejtorit të Institutit të Historisë në Akademinë e Shkencave të RSH.

Monografia "Shkollat e para kombëtare shqipe", që u botua më 1973, pati jehonë të gjerë, sidomos në qarqet që studionin historinë e arsimit shqip. Dy vjet mbrapa u përkthye në shqip "Perandoria Osmane" e Halil Inaçikut, për të cilin Hysniu kishte konsideratë të veçantë se ai kishte ligjëruar në Harvard dhe Kolumbia, në Filadelfia, në Universitetin e Princetonit, në Çikago dhe në Ankara.

Prof. Hysniu i jepte rëndësi të veçantë dokumenteve arkivore. Kishte punuar një kohë të gjatë në arkiv. Kur fliste për këto dokumente, nuk ishte më ai Hysniu i ndrojtur, i qetë, i butë, por shndërrohej në një diskutant të pasionuar, analist të mirëfilltë dhe këmbëngulës, sidomos kur ishte ndonjë problem me rëndësi në fushën e arsimit. Pikërisht kjo e ka shtyrë atë që, shumicën e botimeve të tij, t'i shoqërojë me dokumente të ndryshme arkivore.

Dokumentet, me të cilat kishte punuar për një kohë të gjatë në arkiv, e rrëmbenin, e elektrizonin, i jepnin forcë, por edhe e nënshtronin. Shumë nga tekstet e tij përmbajnë "Dokumente dhe materiale të zgjedhura". Le të marrim botimet e viteve 1987 dhe ato të vitit të fundit, d.m.th., 2004.

"Mësonjëtorja e parë shqipe e Korçës", e botuar me rastin e 100-vjetorit të shkollës shqipe të Korçës, nën titullin "Dokumente dhe materiale", faqe 139-189 përmban: letërkëmbime, vjersha, raporte diplomatësh, artikuj, kujtime etj. Vepra tjetër "Nuçi Naçi" e botuar në të njëjtin vit, në të njëjtin përvjetor, nga Sektori i Historisë së Arsimit të Institutit të Studimeve Pedagogjike, përmban në faqet 165-303 dokumente të nivelit arkivor, si: "Letra e N. Naçit, dërguar nga Korça kryetarit të Shoqërisë "Ditura" të Bukureshtit -

26.06.1900", "Parathënia" e tekstit mësimor "trup-tregonja", që N. Naçi e përfundoi një shekull më parë, nga korrespondenca e N. Naçit dërguar nga Shkodra, Shoqërisë "Bashkimi" në Bukuresht (1907), riprodhime të artikujve të N. Naçit për qytetet Krujë, Elbasan, Shkodër dhe shkodranët, shqiptarët në Jemen, Janinë, të botuara në shtypin e kohës (me pseudonime), të dhëna historike për shkollën shqipe në Korçë, botuar në revistën "Dituria" (volumi i dytë 1927).

Nga botimet e fundit të monografive të prof.dr. Hysni Myzyrit, "Shkolla Normale e Elbasanit", fq. 303-439, përmban "Dokumente dhe materiale të zgjedhura", ku përfshihen: "Rregullorja e shkollës Normale të Bukureshtit" e vitit 1882, korrespondenca e Nikolla Naços, Filip Shirokës, Dudë Karbunarës, Gjerasim Qiriazit, artikujt e shtypit mbi shkollat, sidomos për arsimin kombëtar, letra mbi qëndrimin e klubeve, sidomos në formë thirrjesh, vendimet e Kongresi të Elbasanit, rregullore, fjala e Luigj Gurakuqit mbajtur me rastin e përrurimit të Shkollës Normale të Elbasanit etj.

Prof.dr. Hysni Myzyri ishte një historian serioz, njohës i mirë i historisë e, sidomos, i periudhës së Rilindjes Kombëtare. Ishte i saktë dhe gjakftohtë në analizat që i nevojiten gjithmonë historianit.

Në redaksinë e revistës "Univers" ai ka dhënë një kontribut të shquar me ndërhyrjet e tij me karakter shkencor, aktualizimit që i përket kërkesave të shoqërisë sonë, dhe me bashkëpunimin e tij si autor i disa artikujve me karakter studimor, që kanë vlerë në mënyrë të veçantë në fushën e kulturës e sidomos figurave kryesore të periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare, asaj para Luftës së Dytë Botërore. Në tetë numrat që kanë qarkulluar, që nga viti 2001, kur qarkulloi numri i parë i "Universit", prof.dr. Hysni Myzyri shkroi katër artikuj:

1. Letra të panjohura të Mithat Frashërit dhe të Louis Benloewit (Universi Nr. 2, fq. 73-91),
  2. Disa qendra në mbrojtje të kombit (Nr. 3, fq. 15-33),
  3. Shpallja e Mbretërisë Shqiptare dhe statuti themeltar (nr. 5, fq. 49-67) dhe
  4. Dy letra të panjohura të Faik Konicës (Nr. 7, fq. 246-253).
- Tre nga këto punime janë të shoqëruara me referenca të

pasura që ia lehtësojnë vëmendjen lexuesve.

Vlera e studimeve të prof. H. Myzyrit, i cili gjatë këtyre viteve njohu për së afërmi botën orientale e që në të shkuarën ka pasur lidhje me atë shqiptare, çmohet ngase ai është në rolin e dëshmitarit okular. Gjithashtu, që me dokumentet që ai paraqet, dëshmon fakte të panjohur lidhur me historinë kombëtare dhe protagonistët e saj në fusha të ndryshme, sidomos në periudhën e Rilindjes sonë.